



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Zyra e Kryesuesit të Kuvendit

Nr. 02/193

Datë: 26.06.2025

Mbështetur në nenin 43, paragrafi 1, neni 44, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 9 të Rregullores nr.02/175 datë: 31.05.2017 për punën e Kuvendit, Komiteteve, dhe Komisioneve të Komunës së Malishevës, në bazë të nenit 27 paragrafi 29.10 të Statutit të Komunës së Malishevës, miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Malishevës me datë: 11.09.2023 (nr.02/441, datë:14.09.2023);

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës me datë: 26.06.2025;

T H Ë R R E T

Mbledhjen e -II- (dytë) të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2025, e cila do të mbahet ditën e **Hënë** me datë: **30.06.2025**, duke filluar nga ora **10:30**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ftohet z/zj. _____ që të marr pjesë në këtë mbledhje.

Për këtë mbledhje propozoj këtë;

R E N D I D I T Ë S

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2026-2028, me theks të veçantë për vitin 2026.
2. Të ndryshme

Ardhja e juaj është e domosdoshme.
Malishevë, Qershor - 2025

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi



PRANUAR ME: 30/05/2025
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr.Ng.Br. 04/326.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Malishevës



DATE/A:	26/05/2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z.Argjend Thaqi-Kryesues i Kuvendit Komunal
ACC:	
NGA/OD/FROM:	Ekrem Kastrati –Kryetar i Komunës së Malishevës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Blerim Thaçi-Drejtor për Ekonomi Buxhet dhe Financa
KOPJE:	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për dorzimin e KAB-it Komunal për vitin 2026/28

[Signature]
Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe Financa
Blerim Thaçi



Të nderuar,

Duke ju referuar qarkorës Buxhetre 2026/01 të datës 05.05.2025 të nxjerrë nga Ministria e Financave dhe Transfereve për shpërndarjen e Buxhetit për vitet 2026/28 si dhe ne bazë të LMFPF, Komuna e Malishevës ka përpiluar Kornizën Afatëmesme Buxhetore të Komunës së Malishevës 2026-2028 me theks të veçantë për vitin 2026 e cila përmban:

Stafi me politika te reja	1.382
Paga dhe meditje	13,145,020.48
Mallra dhe shërbime	2,555,812.00
Komunali	500,000.00
Subvencionet dhe Transferet	600,000.00
Investimet kapitale	5,287,877.52
Totali	22,088,710.00

KAB- Komunal duhet miratuar nga KPF dhe Kuvendi Komunal.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa

Draft

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

2026 - 2028

Malishevë, Qershor 2025

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Deklarata e Komunës ne lidhje me prioritetet strategjike te zhvillimit ..	4
3. Korniza afatmesme buxhetore.....	5
3.1. Objektivat e kornizës afatmesme buxhetore.....	5
3.2. Objektivat dhe përfitimet e procesit të kornizës afatmesme buxhetore për komunat..	6
4. Korniza ekonomike fiskale.....	6
4.1. Perspektiva e politikave fiskale.....	8
5. Të hyrat vetanake komunale dhe parashikimet afatmesme 2024-2026.....	8
6. Strategjia zhvillimore për sektorët komunal.....	20
7. Programi komunal i investimeve publike.....	21


Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritarë, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizes Afatmesme Buxhetore, pëmban një detyrim për programet-nenprogramet buxhetore të Komunës të kerkuara nga Qarkoria Buxhetore Komunale nr.2026/1 për Komunitet e Kosovës e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve .

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve në Komunë dhe shpërndarjen e të hyrave komunale për periudhën 2026-2028.

Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026-2028, do të hartohet, ndryshohet, plotësohet dhe do të aprovohet sipas procedurave të përcaktuara me Qarkoren Buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, dhe do të kalojë nëpër katër faza si vijon:



2. Deklarata e Komunës ne lidhje me prioritetet strategjike te zhvillimit

Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Malishevës është vazhdimisi e kornizave të viteve të mëparshme dhe është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Republikës së Kosovës, e cila është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2026-2028 dhe agjendës në Qarkoren Buxhetore 2026/01 për komuna e lëshur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Planifikimi i buxhetit për periudhën 2026-2028, do të bëhet sipas kalendarit të përcaktuar ligjor dhe rregullativave ligjore të buxhetit, gjithnjë, në bashkëpunim me grupe të veçanta të interesit, si përmbledhje e projekteve të veçanta sektoriale dhe projekteve të tjera zhvillimore. KAB-i do të punohet në mbështetje me praktikatat e vendeve të zhvilluara të përshatura me përvojën dhe praktikatat lokale dhe të harmonizuara me nevojat, prioritetet dhe dokumentet strategjike të Komunës së Malishevës. Ky dokument në vete përmban aktivitete zhvillimore në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Suksesi i aplikimit dhe renditjes së këtyre segmenteve zhvillimore është qëllim i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028 dhe në parim përmban qëllime dhe objektiva të cilat janë të realizueshme përmes projekteve të veçanta.

Qëllimet e këtij dokumenti si dhe qëllimet e kryetarit të komunës të bazuara në dokumentet strategjike është që Buxheti i Komunës të ketë karakter të theksuar publik të shprehur jo vetëm në debate dhe dëgjime publike por të bazuar edhe në nevojat e theksuara nga qytetarët, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre, me qëllim të arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm, stabil dhe konform nevojave dhe prioriteteve të Malishevës. Në zhvillim dhe hartim të këtij dokumenti kemi ndjekur praktikatat e vendeve me ekonomi dhe demokraci të avancuar ku si synim është vendimmarrja, përgjegjësia dhe llogaridhënia qytetare dhe ajo komunale.

Komuna e Malishevës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, respektivisht në pjesën lindore të Rrafshit të Dukagjinit, ka një sipërfaqe prej 306.48 km² (2.8% të territorit të Kosovës). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Malishevës ka 43 fshatra me qendër administrative në qytetin e Malishevës.

Sipas regjistrimit të fundit (2024), në Komunën e Malishevës jetojnë 43.888 banorë, që përbëjnë 2.74% të banorëve të Kosovës, me një dendësi prej 143.2 banorë në 1 km². Prej numrit të gjithëmbarsheëm të banorëve në komunë, 22.572 (51.43%) janë femra, ndërsa 21.316 (48.57%) janë meshkuj. Sipas grup-moshave, ka një popullsi aktive (15-64 vjeç) prej 65.34%, të numrit të përgjithshëm të banorëve, ndërsa 37.47% i takojn moshës rinore. Janë 8.563 ekonomi familjare me një madhësi mesatare prej 5.12 persona për familje.

Duke ju referuar shenimeve të nxjerra nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës është konstatuar se në komunën e Malishevës zhvillojnë aktivitet afërsisht 1.729 biznese private. Shumica (67 %) prej këtyre bizneseve janë ndërmarrje të vogla, me numër të të punësuarve prej 1-9 punëtorë. Veprimtaria e tyre është kryesisht tregtare (afro 30%), prodhuese (11%), ndërtimore (24%), transportuese (4 %), hoteliere (7%), shërbyese (17%) dhe të tjera të ndryshme (7%).

Administrata e Komunës së Malishevës është e organizuar përmes zyrave qendrore, që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, të cilat janë të vendosura në ndërtesën administrative të Komunës.

Prioritetet e Qeverisë Komunale siq janë: shërbimet adekuate shëndetësore, qytet të paster dhe siguri maksimale për qytetar, përmirsim të preksheëm të ambientit të biznesit, zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë dhe zhvillimi rural me të gjitha degët e saj, rritja e performancës në arsim për të gjitha nivelet, rritja e Buxhetit nga të Hyrat Vetanake Komunale, ambient komod për mërgatën, investimet me partneritet publiko-privat, thitja e fondeve të ndryshme, shërbime të shpejta për qytetarët, zhvillim të ekonomisë, turizmit etj, do të jen të financuara nga ky buxhet përmes programit të investimeve kapitale.

3. Korniza afatmesme buxhetore

Korniza afatmesme buxhetore e komunës është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e cila është e ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore 2026-2028 të dhëna nga MFPT-i përmes qarkores buxhetore 2026/01.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me KAB–Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave – prioriteteve, të tanishme dhe afatmesme të Malishevës si dhe projektsonet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2026-2028.

3.1. Objektivat e kornizës afatmesme buxhetore

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2026 – 2028, planifikohet në bazë të buxhetit, i cili bazohet në "Buxhetin e programeve" dhe është i bazuar në objektivat dhe në deklaratat e misioneve të programeve. KAB-ja komunale 2026–2028, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore nr. 2026/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve.

Me Kornizën afatmesme buxhetore 2026-2028 të Komunës së Malishevës, synohet të arrihen këto objektiva :

- Zhvillimin ekonomik;
- Planifikimin urban dhe rural;
- Shfrytëzimin e tokës;
- Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- Mbrojtjen e mjedisit lokal;
- Formimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve, drenazheve, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transporti lokal;
- Përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Ofrimin e për kujdesit publik primar shëndetësor;

- Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për strehim familjar raste emergjente, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit;
- Banimin publik;
- Shëndetësinë publike;
- Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- Emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Aktivitetet kulturore dhe të lira.

3.2. Objektivat dhe përfitimet e procesit të kornizës afatmesme buxhetore për komunal

Inkorporimi i qasjes së KAB-së në proceset e buxhetit komunal, është i motivuar nga qëllimet e mëposhtme:

- Të ofrojë kornizë gjithëpërfshirëse dhe reale për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme;
- Të risë parashikimin dhe qëndrueshmërinë e planifikimit të buxhetit, përmes fuqjes së parashikimit më të besueshëm të të hyrave komunale dhe shpenzimeve në perspektivë trevjeçare;
- Të përmirësojë lidhjen në mes procesit të alokimit të burimeve dhe prioriteteve të politikave komunale;
- Të fuqizohen drejtoritë komunale në shpërndarjen e burimeve, menaxhim dhe shfrytëzim;
- Të bëhet planifikimi sa më objektiv nëpër kategori ekonomike – BDMS;
- Të bëhet alokimi i mjeteve buxhetore për vitet e ardhshme sipas kategorive ekonomike;
- Planifikimi i investimeve kapitale përmes sistemit të PJP-së;
- Përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një implementim i nevojshëm për të garantuar parimin e barazisë gjinore.

4. Korniza ekonomike fiskale

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makro-ekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2026-2028 të hartuar nga Qeveria e Kosovës.

Tabela 1. Pagat dhe Shitesat

Kodi i prog.	Programet buxhetore	Buxheti	Parashikimet		
		2025	2026	2027	2028
160	Zyra e Kryetarit	84,720.00	84,720.00	84,720.00	84,720.00

169	Zyra e Kuvendit Komunal	220,428.00	220,428.00	220,428.00	220,428.00
163	Administrata dhe Personeli	387,957.00	387,957.48	387,957.48	387,957.48
175	Buxhet dhe Financa	195,096.00	195,096.00	195,096.00	195,096.00
180	Shërbimet Publike dhe Emergjencia	287,237.00	287,237.00	267,717.60	267,717.60
195	Zyra Komunale për Komunitete	8,364.00	8,364.00	8,364.00	8,364.00
470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvill. Rural	163,083.00	134,892.00	134,892.00	134,892.00
480	Zhvillimi Ekonomik	25,483.00	25,483.20	25,483.20	25,483.20
650	Kadastra dhe Gjeodezia	67,980.00	64,348.80	64,348.80	64,348.80
654	Sherbimet Ligjore dhe Pronë	31,884.00	31,111.20	31,111.20	31,111.20
660	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	97,049.00	96,240.00	96,240.00	96,240.00
730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	1,766,670.00	1,715,371.00	1,715,371.00	1,715,371.00
850	Kultura, Rinia dhe Sportet	93,362.00	78,661.44	78,661.44	78,661.44
755	Sherbimet Sociale dhe Rezidenciale	146,283.00	182,013	182,013	182,013
920	Arsimi dhe Shkenca	9,569,424.00	9,516,135,76	9,716,135,76	9,716,135,76


Gjithsej:	11,713,202	13,145,020.48	13,208,539.48	13208,539.48	

-Duke u bazuar në kornizën në fjalë dhe parametrat tjerë në lidhje me të hyrat dhe të dalurat në periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet që sektorët e komunës do të kenë këto të hyra dhe të dala:

Tabela 2. Buxheti aktual 2025 dhe kufijt buxhetor për periudhën 2026 – 2028

Kategoritë buxhetore	Buxheti	Parashikimet			
	2025	2026	2027	2028	
Granti i përgjithshëm	8,898,994	8,898,994	9,502,618	10,262,584	
Granti i arsimit	8,915,744	8,834,248	9,099,275	9,372,254	
Granti i shëndetësisë	2,101,281	2,256,520	2,324,215	2,393,942	
Shërbimet rezidenciale	155,000	155,000	200,000	200,000	
THV	1,505,526	1,943,948	2,063,570	2,068,042	
Gjithsej:	21,576,545	22,088,710	23,189,678	24,296,822	

Grafiku- Buxheti aktual 2025, dhe kufijt buxhetor 2026-2028



4.1. Perspektiva e politikave fiskale

Ky dokument bazohet në informatat dhe analizat e përfshira në Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2026-2028. Veç kësaj, vëmendje e duhur i është kushtuar politikave fiskale (politikës së të ardhurave dhe politikës së shpenzimeve), zotimeve të Qeverisë së Kosovës të përfshira në Memorandumin e politikave ekonomike e fiskale.

Dokumenti bënë prezantimin e shkurtër lidhur me mënyrën e zotimit të planifikuar të qeverisjes lokale, lidhur me politikat fiskale që ndikojnë në buxhetin e komunës të ndërlihdura me ndryshimet në kufijtë në mes të shpenzimeve operative (pagat + shtesat dhe mallrat + shërbimet), si dhe shpenzimeve kapitale, që do të reflektohen në përmirësimin e infrastrukturës publike në njëtrën anë, si dhe në sigurimin e kushteve të mundshme në drejtim të rritjes së arkëtimit të taksave, ngarkesave dhe tatimit në prone si dhe tatimi në tokë. Të gjitha këto do të jenë si rezultat i ngjitjes dhe promovimit të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektshmërisë së shpenzimeve të parashë publike.

5. Të hyrat vetanake komunale dhe parashikimet afatmesme 2026-20268

Të hyrat komunale të komunes realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushteti Lokal, Rregullores mbi Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë lloje të ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë: Tatimi në pronë, Taksat nga ushtrimi i veprimtarisë afariste dhe taksat komunale për leje ndërtimi të cilat të hyra duhet të shpenzuar dhe ekskluzivisht dedikohen në sferën e investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime tjera që iu kthehen qytetarve (tatim pageseve) në investime dhe ngrijen e infrastrukturës komunale

Të hyrat vetanake të komunës përbehen nga:

- Tatimi në pronë
- Tatimi në tokë
- Taksat për ushtrim të veprimtaris afariste
- Taksat për regjistrimin e veturave
- Taksa administrative komunale
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa për shërbime kadastrale
- Taksa për përcaktimin e hipotekës
- Taksa për qertifikata (lindjes, kurorizimit, vdekjes),
- Të hyrat nga qiraja e objekteve komunale
- Të hyra tjera.

Për periudhën e ardhshme tri vjeçare planifikohet rritja e të hyrave duke u bazuar në këta faktorë:

- ✓ ekzekutimi i borxheve të bartura,
- ✓ implementimi i instrumenteve ligjore për zbatim,
- ✓ mbledhja e qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale nga ndërmarrjet ose personat fizik,
- ✓ të hyrat e tatimit në pronë dhe
- ✓ taksat – ngarkesat tjera

Për të bërë planifikimin dhe shpërndarjen e drejtë për të dalat publike me Kornizën afatmesme buxhetore komunale 2026-2028, në mënyrë të saktë egzistojnë vështrësi nga se mungojnë tregues të saktë zhvillimor.

Në drejtim të shpërndarjes dhe planifikimit të drejtë të parasë publike në këtë vit është përdorur në nivel të Kosovës, formula me të cilën janë paraparë indikatorët –kriteret, për shpërndarjen e granteve.

Për shpërndarjen e Grantit të përgjithshëm në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- popullsia e komunës,
- sipërfaqja e komunës,
- komunat e minoriteteve,
- popullsia e minoriteteve në komunë dhe
- shuma fikse për komuna.

Për shpërndarjen e Grantit specifik për arsim në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- numri i shkollave në komunë,
- numri i nxënësve në shkolla fillore,
- numri i nxënësve në shkolla të mesme,
- numri i nxënësve shumicë si dhe
- numri i nxënësve pakicë.

Për shpërndarjen e Grantit specifik për shëndetësi në nivel të Kosovës kanë shërbyer këta indikator:

- popullsia në komunë dhe
- numri mesatar i kontrolleve për kokë banori.

Në bazë të kriterëve të përcaktuara me parë është planifikuar që ndarja e grantëve do të bëhet në mënyrë të drejtë dhe do i përmbush të gjitha nevojat fiskale për tërë sektorët në nivel komunal.

Bazë për planifikimin e të hyrave, ka shërbyer Qarkorja buxhetore 2026/01, për komunat, e lëshuar nga MFPT, ku janë paraqitur kuifinjët e grantëve të aprovuara nga Komisioni i grantëve të ndarë si Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik për Arsim, dhe Granti Specifik për Shëndetësi, Granti për Shërbime Rezidenciale, si dhe parashikimi i të hyrave vetanake të komunës sipas fushave kryesore të hyrave duke u bazuar në politikat e të hyrave të komunës.

Tabela 3. Planifikimi I të hyrave vetanake komunale 2026-2028

Burimet e financimit	2025	2026	2027	2028
BUXHETI TOTAL:	21,576,545.00	22,088,710.00	23,189,678.00	24,296,822.00
Granti qeveritar	20,071,019.00	20,144,762.00	21,126,108.00	22,228,780.00
Granti i përgjithshëm	8,549,194.00	8,898,994.00	9,502,618.00	10,262,584.00
Granti për arsim	9,255,954.00	8,834,248.00	9,099,275.00	9,372,254.00
Granti për shëndetësi	2,101,281.00	2,256,520.00	2,324,215.00	2,393,942.00
Shërbimet rezidenciale	155,000.00	155,000.00	200,000.00	200,000.00
TË HYRAT VETANAKE	1,505,526.00	1,943,948.00	2,063,570.00	2,068,042.00
Të hyrat tatimore	1,095,388.00	1,488,400.00	1,562,820.00	1,562,820.00
Të hyrat jotatimore	410,138.00	455,548.00	500,750.00	505,222.00
Tatimi në pronë	334,434.00	367,005.00	393,613.00	397,549.00
Tatimi në tokë	75,704.00	88,543.00	107,137.00	107,673.00
Drejtoria për buxhet dhe financa	157,000.00	345,700.00	329,500.00	357,500.00
Licencat dhe lejet	102,000.00	58,000.00	66,600.00	70,000.00
Taksë për ushtrimin e veprimtarisë		159,000.00	163,400.00	175,000.00
Qiraja nga objektet publike		15,000.00	15,500.00	18,000.00
Licencat për shërbimet profesionale				

Licencat tjera për afarizëm		15,000.00	3,000.00	3,500.00
Taksë për regjistrimin e atomjeteve	45,000.00	65,000.00	75,000.00	83,500.00
Taksa tjera administrative	10,000.00	33,700.00	6,000.00	7,500.00
Drejtoria për administratë të përgjithshme	174,526.00	65,300.00	81,500.00	91,500.00
Taksa e pjesmarjes në tender				
Taksa për certifikata të lindjes	18,000.00	45,000.00	55,000.00	60,000.00
Taksa për certifikata të kurorëzimit	65,000.00	9,800.00	10,000.00	12,000.00
Taksa për certifikatat e vdekjes	5,000.00	5,500.00	6,500.00	7,500.00
Taksa tjera	86,526.00	5,000.00	10,000.00	12,000.00
Drejtoria për urbanizëm	355,862.00	549,600.00	536,120.00	445,820.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	332,862.00	524,100.00	509,620.00	419,820.00
Taksa për demolin	18,000.00			
Taksa për legalizimin e objekteve		19,000.00	19,500.00	18,500.00
Taksa administrative për fletëkërkesë	5,000.00	6,500.00	7,000.00	7,500.00
Drejtoria për gjeodezi dhe kadastrë	13,000.00	67,500.00	73,000.00	80,500.00
Taksa për matjen e tokës në teren	4,000.00	4,500.00	7,500.00	8,000.00
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	8,500.00	48,000.00	49,000.00	55,000.00
Taksa administrative për fletëkërkesë	500.00	15,000.00	16,500.00	17,500.00
Drejtoria e shërbimeve publike	92,000.00	86,000.00	96,500.00	111,800.00
Taksa komunale për leje – gërmim	70,000.00	25,000.00	30,000.00	35,000.00
Taksa për shfrytëzimin e pronës publike	22,000.00	60,000.00	65,000.00	75,000.00
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare				
Taksa për mbeturina				

Taksa administrative për fletëkërkesë		1,000.00	1,500.00	1,800.00
Drejtoria e inspektionit	30,000.00	33,500.00	43,000.00	50,500.00
Taksa administrative për fletëkërkesë				
Gjoha nga inspektoriati	15,000.00	15,500.00	39,500.00	45,000.00
Gjohat tjera	15,000.00	18,000.00	3,500.00	5,500.00
Drejtoria për bujqësi pylltari dhe Zhr	6,000.00	48,000.00	61,500.00	72,300.00
Taksa nga ndërrimi i destinimit të tokës	5,000.00	12,000.00	15,000.00	15,500.00
Taksa nga licenca e gurthyesve				
Taksa nga shfrytëzimi i pyjeve	1,000.00	1,000.00	1,500.00	1,800.00
Taksa nga qiraja e tokës bujqësore				
Të hyrat nga participimi në Bujqesi		35,000.00	45,000.00	55,000.00
Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim	13,000.00	14,500.00	18,500.00	19,500.00
Taksa nga largimi dhe deponimi i automjeteve		0.00		
Taksa nga gjohat në trafik	13,000.00	14,500.00	18,500.00	19,500.00
Taksa nga inspektimi I ambientit				
Taksa administrative për fletëkërkesë				
Drejtoria për arsim	185,000.00	208,800.00	225,000.00	235,000.00
Të hyrat nga qerdhja e fëmijëve	185,000.00	208,800.00	225,000.00	235,000.00
Të hyrat nga participimi i arsimit joformal				
Taksa administrative për fletëkërkesë				
Drejtoria e shëndetësisë dhe MS	68,000.00	96,700.00	96,700.00	96,700.00
Të hyrat nga participimi në shëndetësi	68,000.00	68,000	96,700.00	96,700.00
Taksa administrative për fletëkërkesë				

<i>Drejtoria për kulturë, rini dhe sport</i>		1,000.00	1,500.00	1,500.00	1,700.00
Të hyrat nga biblioteka		1,000.00	1,500.00	1,500.00	1,700.00

Tabela 4. Buxheti brenda kufijëve buxhetor, 2026-2028, sipas Qarkores buxhetore nr. 2026/01

625	Malishevë	Përshkrimi	Stafi	Pagat	M/SH	Komunalit	Subvencione t	Kapitalet	Totali-2026	Totali-2027	Totali-2028
		TOTAL SHPENZIMET	1,381	13,145,020.48	2,555,812.48	500,000.00	600,000.00	5,287,877.04	22,088,710.00	23,189,678.00	24,296,822.00
		Grantet Qeveritare	1,381	13,145,020.48	2,242,486.48	500,000.00	0.00	4,257,255.04	20,144,762.00	21,126,108.00	22,228,780.00
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja			313,326.00	0.00	600,000.00	1,030,622.00	1,943,948.00	2,063,570.00	2,068,042.00
160	Zyra e Kryetarit		7	84,720.00	8,500.00	0.00	92,000.00	-0.00	185,220.00	185,220.00	185,220.00
		Grantet Qeveritare	7	84,720.00	8,500.00	0.00	0.00	0.00	93,220.00	93,220.00	93,220.00
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja					92,000.00		92,000.00	92,000.00	92,000.00
16013	Zyra e Kryetarit		7	84,720.00	8,500.00	0.00	92,000.00	0.00	185,220.00	185,220.00	185,220.00
		Grantet Qeveritare	7	84,720.00	8,500.00				93,220.00	93,220.00	93,220.00
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja					92,000.00		92,000.00	92,000.00	92,000.00
169	Zyra e Kuvendit Komunal		31	220,428.00	25,000.00	0.00	0.00	0.00	245,428.00	245,428.00	245,428.00
		Grantet Qeveritare	31	220,428.00	25,000.00				245,428.00	245,428.00	245,428.00
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja									
163	Administrata dhe personeli		44	387,957.48	746,181.48	0.00	0.00	0.00	1,134,138.96	1,467,465.48	1,467,465.48
		Grantet Qeveritare	44	387,957.48	641,655.48	0.00	0.00	0.00	1,029,612.96	1,362,939.48	1,362,939.48
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja		0.00	104,526.00				104,526.00	104,526.00	104,526.00
				0.00							

16313	Administrata		43	375,756.00	736,581.48	0.00	0.00	0.00	1,112,334.96	1,445,661.48	1,445,661.48
	Grantet Qeveritare		43	375,753.48	632,055.48				1,007,808.96	1,341,135.48	1,341,135.48
	Të hyrat vetanake			0	104,526.00				104,526.00	104,526.00	104,526.00
	Financim nga huamarrja			0							
16502	Çështjet gjinore		1	12,204.00	9,600.00	0.00	0.00	0.00	21,804.00	21,804.00	21,804.00
	Grantet Qeveritare		1	12,204.00	9,600.00	0.00	0.00	0.00	21,804.00	21,804.00	21,804.00
	Të hyrat vetanake			0							
	Financim nga huamarrja			0							
175	Buxheti dhe financat		22	195,096.00	25,500.00	0.00	0.00	0.00	220,596.00	220,596.00	220,596.00
	Grantet Qeveritare		22	195,096.00	25,500.00	0.00			220,596.00	220,596.00	220,596.00
	Të hyrat vetanake			0					0.00	0.00	0
	Financim nga huamarrja			0					0.00	0.00	0
17513	Buxhetimi		22	195,096.00	25,500.00		0.00	0.00	220,596.00	220,596.00	220,596.00
	Grantet Qeveritare		22	195,096.00	25,500.00				220,596.00	220,596.00	220,596.00
	Të hyrat vetanake			0					0.00	0.00	0
	Financim nga huamarrja			0					0.00	0.00	0
180	Shërbimet publike		29	287,237.00	245,477.00	322,400.00	70,000.00	2,980,729.52	3,905,843.52	3,723,816.60	3,723,816.60
	Grantet Qeveritare		29	287,237.00	245,477.00	322,400.00	0.00	1,950,107.52	2,805,221.52	2,623,194.60	2,623,194.60
	Të hyrat vetanake						70,000.00	1,030,622.00	1,100,622.00	1,100,622.00	1,100,622.00
	Financim nga huamarrja										
18013	Infrastruktura rrugore		6	59,652.00	227,977.00	322,400.00	70,000.00	2,880,729.52	3,560,758.52	3,498,251.00	3,498,251.00
	Grantet Qeveritare		6	59,652.00	227,977.00	322,400.00		1,950,107.52	2,560,136.52	2,397,629.00	2,397,629.00
	Të hyrat vetanake			0			70,000.00	930,622.00	1,000,622.00	1,100,622.00	1,100,622.00
	Financim nga huamarrja			0					0.00	0.00	0
18417	Zjarrefikësit dhe inspektimet		23	227,585.00	17,500.00	0.00	0.00	0.00	245,085.00	225,565.60	225,565.60
	Grantet Qeveritare		23	227,585.00	17,500.00	0.00	0.00	0.00	245,085.00	225,565.60	225,565.60
	Të hyrat vetanake										
	Financim nga huamarrja										
195	Zyra komunale për komunitete		1	8,364.00	5,000.00	0.00	0.00	0.00	13,364.00	13,364.00	13,364.00

65065	Sherbimë Kadastrale		7	67,980.00	15,000.00				0.00	82,980.00	79,348.80	79,348.80
		Grantet Qeveritare	7	64,348.80	15,000.00					64,348.80	64,348.80	64,348.80
		Të hyrat vetanake		0						1,030,622.00	1,030,622.00	1,030,622.00
		Financim nga huamarrja		0								
65465	Sherbimet Llogjore dhe Pronë		3	31,884.00	6,800.00	0.00	0.00		0.00	38,684.00	37,911.20	37,911.20
		Grantet Qeveritare	3	31,884.00	6,800.00				0.00	38,684.00	37,911.20	37,911.20
		Të hyrat vetanake							0.00	0.00	0.00	0
		Financim nga huamarrja										
660	Planifikimi urban dhe mjedisi		9	97,049.00	4,650.00	0.00	0.00		2,203,133.52	2,311,182.52	2,289,603.52	2,289,603.52
		Grantet Qeveritare	9	97,049.00	4,650.00	0.00	0.00		2,203,133.52	2,311,182.52	3,062,149.52	4,164,821.52
		Të hyrat vetanake										
		Financim nga huamarrja										
66370	Planifikimi mjedisi dhe inspeksioni		9	97,049.00	11,000.00	0.00	0.00		2,203,133.52	2,311,182.52	2,289,603.52	2,289,603.52
		Grantet Qeveritare	9	97,049.00	11,000.00				2,203,133.52	2,311,182.52	3,062,149.52	4,164,821.52
		Të hyrat vetanake								0.00	0.00	0
		Financim nga huamarrja										
730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale		163	1,766,670.00	455,733.00	57,600.00	68,000.00		37,500.00	2,385,503.00	2,420,636.00	2,420,636.00
		Grantet Qeveritare	163	1,766,670.00	455,733.00	57,600.00	68,000.00		37,500.00	2,317,503.00	2,352,636.00	2,352,636.00
		Të hyrat vetanake								68,000.00	68,000.00	68,000.00
		Financim nga huamarrja										
73022	Administrata e Shëndetësisë		6	60,983.00	0.00	0.00	0.00		0.00	60,983.00	46,116.00	46,116.00
		Grantet Qeveritare	6	60,983.00	0					60,983.00	46,116.00	46,116.00
		Të hyrat vetanake										
		Financim nga huamarrja										
73800	Sherbimet e Shëndetësisë primare		157	1,705,687.00	455,733.00	57,600.00	68,000.00		37,500.00	2,324,520.00	2,374,520.00	2,374,520.00
		Grantet Qeveritare	157	1,705,687.00	455,733.00	57,600.00	68,000.00		37,500.00	2,256,520.00	2,306,520.00	2,306,520.00

		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja								68,000.00	68,000.00	68,000.00	68,000.00
75560	Sherbimet Sociale		9	96,283.00	49,500.00	0.00	0.00						
		Grantet Qeveritare	9	96,283.00	49,500.00							135,528.00	135,528.00
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja										135,528.00	135,528.00
75562	Shërbimet Rezidenciale Malishevë		11	50,000.00	50,000.00	5,000.00	0.00						
			11	50,000.00	50,000.00	5,000.00						150,985.00	150,985.00
850	Kultura, rinia dhe sportet		8	93,362.00	25,800.00	0.00	50,000.00	0.00				154,461.44	154,461.44
		Grantet Qeveritare	8	93,362.00	25,800.00	0.00	0.00	0.00				104,461.44	104,461.44
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja					50,000.00					50,000.00	50,000.00
85013	Kultura		6	71,123.00	12,900.00	0.00	20,000.00	0.00				94,556.00	94,556.00
		Grantet Qeveritare	6	71,123.00	12,900.00							74,556.00	74,556.00
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja					20,000.00					20,000.00	20,000.00
85053	Perkrahja e Rinisë		1	11,248.00	5,950.00	0.00	20,000.00	0.00				34,651.44	34,651.44
		Grantet Qeveritare	1	11,248.00	5,950.00							14,651.44	14,651.44
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja					20,000.00					20,000.00	20,000.00
85093	Sporti dhe Rekreacioni		1	10,991.00	6,950.00		10,000.00					25,254.00	25,254.00
		Grantet Qeveritare	1	10,991.00	6,950.00							15,254.00	15,254.00
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja					10,000.00					10,000.00	10,000.00
920	Arsimi dhe shkenca		1,021	9,569,424.00	863,671.00	115,000.00	120,000.00	66,514.00	10,525,809.00	10,581,320.76		10,581,320.76	10,581,320.76
		Grantet Qeveritare	1,021	9,569,424.00	654,871.00	115,000.00	0.00	66,514.00	10,405,809.00	10,461,320.76		10,461,320.76	10,461,320.76

		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja			208,800.00			120,000.00		120,000.00	120,000.00	
92065	Administrata		5	55,282.00	0.00	0.00	0.00	50,000.00	105,282.00	101,365.04	101,365.04	
		Grantet Qeveritare	5	55,282.00					55,282.00	51,365.04	51,365.04	
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja						50,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00	
92450	Arsimi Parashkollor		112	945,571.00	244,359.00	4,500.00	0.00		1,194,430.00	1,145,010.72	1,145,010.72	
		Grantet Qeveritare	118	945,571.00	35,559.00	4,500.00			985,630.00	936,210.72	936,210.72	
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja			208,800.00				208,800.00	208,800.00	208,800.00	
93360	Arsimi fillor, I mesëm I Ulët		768	7,320,571.00	422,552.00	74,424.00	70,000.00		7,954,061.00	8,062,861.36	8,062,861.36	
		Grantet Qeveritare	768	7,320,571.00	422,552.00	74,424.00			7,884,061.00	7,992,861.36	7,992,861.36	
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja					70,000.00		70,000.00	70,000.00	70,000.00	
94560	Arsimi I mesëm I lartë		130	1,248,000.00	196,760.00	36,076.00	0.00		1,480,836.00	1,480,883.64	1,480,883.64	
		Grantet Qeveritare	130	1,248,000.00	196,760.00	36,076.00			1,480,836.00	1,480,883.64	1,480,883.64	
		Të hyrat vetanake Financim nga huamarrja										

Katër kategoritë e para të shpenzimeve njihen si shpenzime operative të cilat me Qarkore Buxhetore të MFPT-së janë të limituara, për dallim nga kategoria e pestë e cila s'është e kufizuar. Maksimumi i rritjes së lejuar të shpenzimeve operative do të jetë i kufizuar dhe i përcaktuar me Qarkoren e dytë Buxhetore të MFPT-së e cila pritet të shpërndahet nga mesi i korrikut.

Numri i të punësuarve me Buxhetin Komunal 2025 është i lejuar deri në 1372 punëtorë. Ndërsa për vitin 2026 caktohet me kufijtë buxhetorë në Qarkoren buxhetore 2026/02. Shpenzimet operative edhe gjatë viteve në vijim do të kontrollohen në mënyrë rigoroze me tendencë të zvogëlimit të tyre në atë mënyrë që shpenzimet për investime kapitale të shënojnë rritje progressive, nga viti në vit.

Si tani është edhe në të ardhmen do të kushtohet kujdes implementimit më efektiv të shpenzimeve kapitale publike dhe shfrytëzimit të iniciativave të llojit të partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat dhe ky do të jetë synim kryesor për vitet në vijim.

Ndarja sektoriale e shpenzimeve në vitin 2026 planifikohet si vijon:

- ❖ Granti i përgjithshëm duke u bazuar në burimin e të hyrave buxhetore të nivelit qendror është I njëjti me vitin e kaluar (2025) pra 0€, krahasuar me vitin 2025, dhe të marr pjesë në buxhetin total të vitit 2026 me shpenzime me 40.29 %.
- ❖ Granti i arsimit është zvogëluar për -0.91% (-81,496.00 €), krahasuar me vitin 2025, dhe të marr pjesë në buxhetin total të vitit 2026 me shpenzime me 39.98 %.
- ❖ Granti i shëndetësisë dhe i mirëqenjes sociale është rritur për 7.39% për (+155,239.00€), krahasuar me vitin 2025, dhe të marr pjesë në buxhetin total të vitit 2026 me shpenzime me 10.22 %.
- ❖ Shërbimet rezidenciale, që financojnë shtëpitë e personave me aftësi të kufizuara (SHKPAK), planifikohet që në vitin 2026 të jenë në shumë prej 155,000 €, dhe të marrin pjesë në buxhet me shpenzime 0.71 %. Mjetet janë të dedikuara për paga dhe shtesa (50,000 €), mallra dhe shërbime (50,000 €), shpenzime komunale (5,000 €) dhe investime kapitale (50,000 €).
- ❖ Të Hyrat Vetanake në vitin 2026, krahasuar me vitin 2025, janë planifikuar që të rriten për 29.12%, dhe të marrin pjesë në buxhetin total me 8.80 %.

Sipas Strategjisë Fiskale 2026-2028, në Sektorin e Arsimit, kemi një zvogëlim të buxhetit me krahasim me vitin paraprak, por kjo është faza fillestare e buxhetimit.

Komuna në procedurat e mëtejshme të buxhetimit do të analizojë mirë këtë buxhet dhe nëse nuk ka Grantë shtesë nga Qeveria e Kosovës, atëherë nevojat e financimit do të përmbushen nga Granti i përgjithshëm i komunës.

Procesi buxhetor do të shërben si mjet për ofrimin e politikave të drejta financiare me prioritet të arsyeshme, në interes të qytetarëve të Komunës së Malishevës.


Tabela 5. Buxheti sipas kategorive Buxhetore, 2026-2028

Kategoritë buxhetore		Buxheti	Parashikimet			
		2025	2026	2027	2028	
1.	Paga dhe shtesa	11,713,202	13,145,020.48	13,208,539.48	13,208,539.48	
2.	Mallra dhe shërbime	2,600,200	2,555,812.48	2,513,171.00	2,513,171.00	
3.	Shpenzime komunale	600,000	500,000.00	500,000.00	500,000.00	
4	Subvencione dhe transfere	600,000	600,000.00	600,000.00	600,000.00	
5.	Shpenzime kapitale	6,063,143	5,287,877.04	6,367,967.52	7,475,111.52	
	TOTALI:	21,576,545	22,088,710.00	23,189,678.00	24,296,822.00	
	Nr. i të punësuarve:	1372	1382	1382	1382	


- **Buxheti në total per vitin 2026 sipas Qarkorës buxhetore 2026/01, është rritur për 2.37%, në krahasim me vitin 2025 (me mundësi të rritjes për 512,165.00€ në vitin 2026, nga të hyrat vetanake).**

- ❖ **Pagat dhe shtesat-** Kategoria e shpenzimeve të pagave dhe shtesave në vitin 2026 merr pjesë në buxhtin total me 58.89%.
- ❖ **Mallrat dhe shërbimet-** Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime , në vitin 2026, merr pjesë me 12.28% në shpenzimet e përgjithshme të buxhetit.
- ❖ **Shpenzimet komunale-** Kjo kategori i atribuohet rritjes së shpenzimeve për pagesën e mbeturinave, për mirëmbajtjen e objekteve shkollore, pagesat për ndriçimin publik, pastrami dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, objekteve shëndetësore, sportive etj. Shpenzimet komunale do të zvogelohen për 100.000.00€, në vitin 2026 në krahasim me vitin 2025, dhe në shpenzimet e përgjithshme do të marrin pjesë me 2.26%.
- ❖ **Subvencionet dhe transferet-** Në vitin 2026, komuna e Malishevës, nga kjo kategori do të subvencionoj bujqësinë, shëndetësinë, arsimin, kulturën, rininë, sportin dhe bursat për student, transportin për nxënës. Kjo kategori , në vitin 2026 , nuk do të ketë rritje, në krahasim me vitin 2025 , ndërkaj në shpenzimet e përgjithshme do të marrin pjesë me 2.71%.
- ❖ **Shpenzimet kapitale-** Kategoria e shpenzimeve kapitale, në vitin 2026, planifikohet të financohet nga buxheti qendror dhe të hyrat vetanake të komunës. Kjo kategori e shpenzimeve do të shënoj ulje të lehtë nga viti në vit gjatë tërë periudhës buxhetore, dhe do të ketë pjesëmarrje në buxhtin total me 23.84%.

Grafiku- Buxheti sipas kategorive buxhetore



Pjesëmarrja e kategorive ekonomike në buxhetin total, në vitin 2026



6. Strategjia zhvillimore për sektorët komunal

Komuna ka të përgatitur dhe të aprovuar Planin Zhvillimor Komunal 2019-2027 dhe në të është cekur **vizioni për të ardhmen** : *“Komuna e Malishevës do të këtë infrastrukturë të përmirësuar fizike dhe mjedis të mbrojtur natyror, ambient të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve, bujqësi intensive, rritje të punësimit, ngritje të nivelit të arsimit dhe të edukimit sipas nevojave të tregut, shërbime cilësore publike, shëndetësore dhe administratë lokale më efikase”*.

Komuna tani është në fazën finale të Vlerësimit Strategjik të Mjedisit për Hartën Zonale të Komunës 2022-2030.

Komuna në tri vitet e ardhshme do të këtë këto objekte për realizim dhe njëherit do të financoj tërësisht apo pjesërisht ato si vijon:

Objektivat:

- Shtimi i efikasitetit në punë që ndikon në zhvillimin ekonomik:
 - përmirësimi i kushteve për shërbime publike,
 - përmirësimi i efikasitetit në shpenzimet e parave publike,
 - shfrytëzimi maksimal i burimeve të mundshme,
 - kryerja e punëve me kohë dhe në mënyrë të duhur.
- **Rritja e shpejtë e të ardhurave :**
 - shkalla më e lartë e arkëtimit të tarifave dhe ngarkesave,
 - insistimi në zgjerimin e fushave kryesore për të hyrat,
 - ngarkesa të reduktuara me tarifa të zgjeruara,
- **Sigurimi i disiplinës financiare :**
 - ✓ pajtueshmëri me politiken financiare, rregullat, rregulloret dhe me udhëzimet ,
 - ✓ ekzistenca e kontrolleve interne,
 - ✓ transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve - informimi publik,
 - ✓ analiza e shpenzimeve ,
 - ✓ evidencë e duhur financiare dhe kontabël,
 - ✓ inventarizim i duhur dhe menaxhim i pronës,
 - ✓ përmirësim i politikës dhe procedurave të prokurimit,
 - ✓ zhvillimi i strategjisë komunale për promovim ekonomik,
 - ✓ krijimi i kushteve për interesimet e investitorëve ,
 - ✓ nxitja e mundësive bankare / mikro kredive ,
 - ✓ plani për zhvillimin e viseve rurale,
 - ✓ marketingu i potencialit zhvillimor të komunës.

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:

- Përgatitja e planit dhe raporteve të punës 2026-2028,
- Zbatimi i planit zhvillimor komunal dhe urban ,
- Përgatitja e hartave zonale,
- Përgatitja e kornizës afatmesme të shpenzimeve 2026-2028,
- Përmirësimi i mbledhjes thelbësore të të dhënave dhe përdorimi i tyre,

- Shqyrtimi i përgjegjësisë dhe obligimeve komunale,
- Kujdesi ndaj palëve (menaxhimi i mirë i zyrës pritëse),
- Zbatimi më përpikëri i ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve në fuqi,
- Vendosja e pajisjeve për tërë stafin.

7. Programi komunal i investimeve publike (PIP)

Kategoria e investimeve kapitale paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Malishevës. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme.

Projektet e propozuara kapitale do të jenë në përputhje me kriteret e akteve ligjore dhe nënligjore, dhe rregullave të përcaktuara me udhëzimet administrative përkatëse.

Projektet e regjistruara në sistemin e PIP-it, do të përgatiten në sajë të kërkesave që rrjedhin nga drejtoritë-programet, të cilat janë të bazuara në nevojat e qytetarëve të komunës së Malishevës dhe subjekteve tjerë. Këto projekte dhe projektet tjera të propozuar, gjatë proceseve buxhetore do të analizohen, shqyrtohen dhe në fund do të aprovohen në kuvend në bazë të mundësisë reale buxhetore që ka komuna për financim gjatë periudhës 2026-2028.

Lista perfundimtare e projekteve në fund të procesit buxhetor do të aprovohet në Kuvend dhe do të jetë pjesë perberëse e këtij dokumenti.

Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa

Drejtori,

Blerim Thaçi

